



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Buletini i aktiviteteve për muajin Gusht 2024

01 gusht 2024

Drejt përfundimit renovimi i Shtëpisë së Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren.

Ky projekt, investim i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka përmirësuar kushtet për rritjen e aktivitetit kulturor, ku, përveç përbushjes së nevojave për artistët e arteve dramatike, është krijuar edhe salla e ekspozitave për artet pamore që është një shtesë e rëndësishme dhe e kompletion funksionalitetin e Shtëpisë së Kulturës.

Transformimi i plotë i kompleksit kulturor do të ofrojë gjithashtu një ambient estetik për dashamirët e teatrit.



02 gusht 2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me Ambasadorin e BE-së në Kosovë, Tomáš Szunyog, vizituan sot muralin e punuar nga artistët e Prizrenit, nën udhëheqjen e Hasan Thaqit, i cili mural paraqet trashëgiminë e pasur kulturore të qytetit tonë, i realizuar si pjesë e aktiviteteve për shënimin e Ditës së Evropës 2024, në murin përgjatë Lumbardhit, pranë urës së Arastës.

"Kënaqësi të diskutosh me artistët që e kanë punuar këtë mural, procesin e punës dhe konceptin interesant të kësaj vepre artistike" - u shpreh me këtë rast Kryetari Totaj.



05 shtator 2024

Në bashkëpunim mes “Dokufest”-it dhe festivalit ukrainas “Docudays” u hap sot “Dokuphoto” – ekspozita më e madhe e festivalit që thekson qëndrueshmërinë e popullit dhe krijimtarinë e kulturës ukrainase, një punë e shkëlqyeshme e fotografit ukrainas Mykhaylo Palinchak, i cili zhytet thellë në jetën dhe peizazhet e atdheut të tij të shkatërruar nga lufta - një dritare në historinë bashkëkohore të luftës së Ukrainës.

Ky bashkëpunim, programi “Focus Ukraine”, tregon përkushtimin e “Dokufest”-it për diversitetin, të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale me përkushtimin gjithashtu të “Docudays” ndaj dinjitetit njerëzor përmes krijimit të filmave dokumentarë.



06 gusht 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot përfaqësuesit e organizatave të bizneseve që veprojnë në Komunën e Prizrenit, për të diskutuar për fenomenin e ngritjes së çmimeve në fushën e hotelerisë (hotelet, restorantet dhe kafeteritë) si dhe të shërbimeve, përfshirë parkingjet, sidomos në pjesën historike të qytetit.

"Me dinamizmin e jetës kulturore, sidomos në sezonin e verës, kur ka edhe shumë vizitorë në qytetin tonë, konsiderojmë se veprimet duhet bashkërisht të harmonizohen me qëllim të ruajtjes së reputacionit të qytetit të Prizrenit.

Loja me çmime në afat të gjatë kohor askujt nuk i sjell përfitime, gjë që tashmë është e konfirmuar.

Të gjitha veprimet do të monitorohen nga inspektorët komunalë dhe publikimi i çmimeve të shërbimeve në vende të dukshme është i domosdoshëm për të siguruar transparencë e për t'i shmangur keqkuptimet apo abuzimet që mund të ndodhin.

Është e rëndësishme që të gjithë akterët të bashkëpunojnë për të siguruar që rritjet e çmimeve janë të arsyeshme dhe të përputhshme me nivelin e shërbimit që ofrohet, pasi, rritja e çmimeve në sektorin e hotelerisë dhe të parkingjeve, sidomos në zonën historike, mund të ndikojë negativisht në përvojën e vizitorëve dhe në imazhin e qytetit" - u shpreh Kryetari Totaj.



07 gusht 2024

Ka përfunduar me sukses procesi i tenderimit për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytetin e Prizrenit.

Pjesë e këtij projekti është jo vetëm instalimi i kamerave në vendet kyçe, por edhe plani i detajuar për mirëmbajtjen e tyre, për ta garantuar kështu funksionalitetin e vazhdueshëm dhe efektivitetin e kamerave.

Ky sistem modern do të ofrojë mbikëqyrje të vazhdueshme nëpër pika strategjike të qytetit dhe do të krijojë ambient më të sigurt për të gjithë.

Komuna e Prizrenit do të nënshkruaj Memorandum Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës e cila do ta bëjë vëzhgimin e kamerave të montuara në qytet.



09 gusht 2024

Në koktejin e mbrëmshëm për nder të edicionit të 23-të të "Dokufest"-it, Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me ekipin e ekzekutivit, pritën në oborrin e Shtëpisë së Bardhë Ambasadorët e SHBA-ve, Gjermanisë, Sllovenisë, Shqipërisë, përfaqësuesit e Ambasadës së Italisë, ata të BE-së, të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë, drejtoreshën e "Peace Corps" si dhe përfaqësues të shumë organizatave të huaja e vendëse, artistë dhe organizatorë të "Dokufest"-it.

Me këtë rast, u theksua rëndësia e Festivalit "Dokufest" si platformë që i sjell Prizrenit jo vetëm vlerë artistike, por edhe mundësi për ta lidhur qytetin tonë me botën, duke tërhequr kështu artistë, regjisorë dhe dashamirë të filmit nga të gjitha vendet e globit.



11 gusht 2024

Për shkak të situatës së krijuar nga zjarret në rajonin e Prevallës, sot, në orët e para të mëngjesit është ngritur Shtabi Emergjent për menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve, ku po qëndron edhe drejtoresha e Emergjencave dhe Sigurisë, Ramize Shala.

Në këtë aksion është angazhuar një numër i madh i zjarrfikësve prizrenas, Policia e Kosovës, zyrtarë të Parkut Nacional, motoristë e qytetarë vullnetarë.

Aktualisht, gjendja është nën kontroll, zjarri është sipërfaqësor, derisa të gjitha ekipet janë të përkushtuara maksimalisht për ta mbrojtur mjedisin dhe sigurinë e banorëve të zonës.



12 gusht 2024

Kryetari Shaqir Totaj mori pjesë dhe në edicionin e III-të të Festivalit Ndërkombëtar të Vallëzimit "NewBorn Kosova", që organizohet nga Federata Ndërkombëtare e Festivaleve të Vallëzimit, dega në Kosovë.

350 artistë, nga 10 shtete të ndryshme të botës, përformuan me vallëzime tradicionale duke përfaqësuar kulturat e veta në disa lokacione turistike të Prizrenit.

"Newborn Kosova", mbahet edhe në Prishtinë, Podujevë dhe Deçan, duke krijuar kështu një imazh mikpritës, artistik e kulturor të Kosovës në botë.



13 gusht 2024

Po vazhdon projekti i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hapjen e kanaleve për ujitjen dhe kullimin e tokave bujqësore në fshatin Nashec, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor në këtë zonë.



14 gusht 2024

Punimet për ndërtimin e qendrës kulturore në fshatin Pouskë, në Zhupë, janë duke vazhduar me ritëm të shpejtë, një projekt i mbështetur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që synon të ofrojë hapësirë të dedikuar për aktivitetet kulturore dhe shoqërore të komunitetit lokal të zonës.



15 gusht 2024

Në vazhden e rehabilitimit të infrastrukturës rrugore në Komunën e Prizrenit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sot u asfaltua rruga që lidh fshatrat Vlashnje dhe Kobaj, investim ky që do ta përmirësojë lëvizjen dhe përditshmërinë e banorëve të kësaj zone.



16 gusht 2024

U përfundua sot një prej rrugëve të reja të shtruara me kubëza (526 metra) në lagjen “Jeta e Re”, në kuadër të projekteve për ndërtimin e infrastrukturës në lagjet e qytetit të Prizrenit.

Ky investim i Drejtorisë së Shërbimeve Publike ka qenë nevojë e kamotshme e banorëve të kësaj pjese për ta lehtësuar qasjen në pronat e tyre si dhe ta përmirësojë cilësinë e jetës, sidomos gjatë sezoneve me lagështira.



19 gusht 2024

Përfundon projekti i renovimit të Shtëpisë së Kulturës në Zym!

Janë përfunduar me sukses punimet në Shtëpinë e Kulturës në Zym të Hasit - projekt i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që tashmë ofron hapësira të reja për aktivitetet kulturore dhe sociale të komunitetit.

ë këtë objekt funksionon edhe dega e bibliotekës së qytetit të Prizrenit, që është mundësi e shkëlqyeshme për banorët për qasje në një gamë të gjerë librash dhe materialeve shkollore.



20 gusht 2024

Në vijim të realizimit të projektit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Hapja e kanaleve për ujitjen dhe kullimin e tokave bujqësore”, po hapen kanalet në fshatin Randobravë, që do të ndikojnë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe në përmirësimin e kushteve të fermerëve.



21 gusht 2024

Projekti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Poslisht është në proces e sipër, ku aktualisht ekipet e ndërtimit janë të angazhuara në disa zona për krijimin e rrugëve të reja, që përmirësojnë infrastrukturën dhe kushtet e jetesës në fshat.

🏢 Objektivi kryesor është modernizimi i rrjetit rrugor dhe sistemit të kanalizimit në Poslisht, që rrjedhimisht ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të kësaj pjese të Komunës së Prizrenit.



22 gusht 2024

Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik filloi sot me realizimin e projektit për hapjen e rrugës dhe rregullimin e hapësirës përreth që shpie në kishën e vjetër ilire të Shën Pjetrit në Kabash, që është një prej lokaliteteve të rëndësishme turistike të Komunës së Prizrenit.



23 gusht 2024


U përrua sot rruga rishtas e asfaltuar (mbi 2200 metra) që lidh fshatrat Vlashnje dhe Kobaj, që do ta lehtësoj lëvizjen e banorëve të zonës, duke ndikuar kështu në cilësinë e jetës së tyre.



24 gusht 2024

Në vazhden e punimeve infrastrukturore në Komunën e Prizrenit, sot u shtrua shtresa e parë e asfaltit në një prej rrugëve të rëndësishme në fshatin Pouskë.

Kjo rrugë, projekt i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, me gjatësi prej 1600 metrash, synon lehtësimin e qarkullimit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e kësaj pjese të Zhupës.



26 gusht 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot Kolonelin Rocco Mundo, komandant i ri i Komandës Rajonale Perëndimore të KFOR-it (RC-Ë), i cili vizitoi Prizrenin në kuadër të takimeve me zyrtarë shtetërorë të Kosovës, në proces të njohjes me situatën dhe zhvillimet në terren.

Veçanërisht diskutuan për marrëdhëniet e ngushta dhe korrekte me KFOR-in, duke theksuar rëndësinë e pranisë së paqeruajtësve në ruajtjen e stabilitetit në Kosovë, për çka Kryetari Totaj shprehu mirënjohjen për kontributin e KFOR-it në krijimin e një ambienti të qetë dhe miqësor për të gjithë qytetarët.

Gjithashtu biseduan për barazinë, gjithë përfshirjen dhe respektimin e të drejtave të të gjithëve, për të cilën gjë Koloneli Mundo tha se Prizreni është shembull konkret për këtë.



27 gusht 2024

Pas një periudhe intensive dëgjimesh publike dhe angazhimi të gjithanshëm me qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-ve, shoqatave dhe biznesit, ju njoftojmë për përfundimin e projektit të buxhetit për vitin 2025, i cili projekt është bërë duke marrë parasysh të gjitha kërkesat, sugjerimet dhe idetë e qytetarëve si dhe është finalizuar me energji dhe përkushtim nga grupi i zyrtarëve komunalë të angazhuar në hartimin e buxhetit.

Dëgjimet publike u kanë ofruar mundësi qytetarëve të kontribuojnë në formimin e qëndrimeve dhe të krijojnë një bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prizrenit. Ky proces ka qenë thelbësor për të siguruar që buxheti t'i reflektojë nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Sot, Kryetari Shaqir Totaj ia dorëzoi projekt buxhetin Kryesueses së Kuvendit Komunal, Antigona Bytyqi, e cila do të vazhdojë me procedurat e nevojshme ligjore deri në miratimin përfundimtar të buxhetit për vitin 2025 nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Pas miratimit në Kuvend, buxheti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit, për transparencë dhe qasje të gjerë për të gjithë qytetarët.



28 gusht 2024

Nxënësit dhe personeli i shkollës në fshatin Pllanjane, vitin e ri shkollor do ta nisin në objektin e ri, të ndërtuar rishtas nga Drejtoria Komunale e Arsimit, me standarde moderne.



29 gusht 2024

Punimet për rregullimin e stadiumit në shkollën “Meto Bajraktari” në Reçan po vazhdojnë sipas planit, projekt ky pjesë e investimeve kapitale të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Aktualisht, po ndërtohet muri i ri rrethues dhe po bëhen përmirësime që përfshijnë rregullimin e tribunave dhe elementeve të tjera të stadiumit, që do të krijojë kushte më të mira për aktivitete sportive dhe do të ofrojë mundësi më të mira për nxënësit dhe komunitetin në përgjithësi.



Kabineti i Kryetarit/Njësia për Komunikim me Publikun